



**Mirjeta Emini**  
Managing Director

+355 68 402 9329  
mirjeta.emini@pwc.com

#### Kualifikimet përkatëse:

- Bachelor i Shkencave - Financë dhe Kontabilitet, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë
- Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)
- Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës
- Instituti i Kontabilistëve të Miratuar (IKM)
- Partners for Change – Anëtare e Bordit

#### Fushat e ekspertizës:

- Eksperiençë të konsoliduar të legjislacionit tatimor
- Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit
- Përmirësimi i legjislacionit tatimor dhe kontabël për shoqëritë tregtare dhe për organizatat jo-qeveritare

#### Aftësitë gjuhësore:

- shqip (amtare)
- anglisht (rrjedhshëm)
- italisht (rrjedhshëm)



#### Roli

Managing Director  
PwC Consulting Shpk



#### Përmbledhje

Mirjeta është një eksperte në fushën e kontabilitetit dhe taksave me eksperiencë rreth 20 vjecare duke ofruar shërbime këshilluese të kontabilitetit, raportimit financiar, çështjeve të legjislacionit tatimor dhe pajtueshmërisë tatimore. Ajo ka ofruar këshilla për shoqëri ndërkombëtare që konsiderojnë investime në Shqipëri dhe Kosovë në të gjithë sektorët e ekonomisë, përfshirë energjinë, prodhimin, sektorin bankar dhe financiar, telekomunikacionin, naftën e gazin etj. Mirjeta ka qenë eksperte në disa nga transaksionet më të rëndësishme në Shqipëri të bashkimit, blerjeve apo përthithjeve, marrëveshjeve koncesionare etj. Ajo ka dhënë mbështetje për shoqëritë në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore sipas SNRF apo SKK, përgatitjen e paketave të raportimit financiar për kompanitë ndërkombëtare, raportimet për organet rregullatore si Banka e Shqipërisë etj.



#### Përvoja përkatëse

- Udhëheqëse e disa prej projekteve madhore në Shqipëri sic janë konsulenca kontabël dhe fiskale për shumë kompani kombëtare dhe ndërkombëtare në Shqipëri dhe Kosovë.
- Asistencë në transaksione të shit-blerjes së shoqërive (ndarje, bashkime, përthithje etj).
- Konsulencë në zbatimin e SNRF dhe SKK.
- Konsulencë në përgatitjen e administratës shtetërore për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP/IPSAS) sipas projektit të Bankes Botërore dhe Ministrisë së Financave
- Asistencë në zbatimin e legjislacionit tatimor dhe efekteve tatimore që rrjedhin nga zbatimi për herë të parë i SNRF të reja etc.

